



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-6871/23 datë:10.03.2023



Npi – 01/88 datë: 15.03.2023

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 15.03.2023, është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I VAZHDIMIT TË MBLEDHJES SË -II- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E mbajtur më: 15.03.2023, (e mërkurë) në ora 09.^{oo} h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, znj.Adelina Beqaj, znj.Albana Podvorica, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Qemajl Aliu, Të gjithë Drejtorët, Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti, Nga OSBE, z.Mefail Mustafa, Asistente e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Shefe e Kabinetit të Kryetarit znj.Anita Kurti, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut, Zyrtarët e IT-së, z.Shqiprim Hyseni, praktikant.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.01.2023,
2. **Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/54 për anëtarin e KPF-së**
3. Pyetje – përgjigje
4. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023 (pas diskutimit publik),
5. Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021,
6. Raport financiar për vitin 2022 - Pasqyrat financiare,
7. Draft-Rregullore për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve,
8. Draft-Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 (Pas diskutimit publik),
9. Draft-Strategjia dhe Plani i Veprimit për mbrojtje nga dhuna në Familje 2023-2025,
10. Draft – Plani Komunal për Integritet 2023-2027,
11. Propozim-Vendim për ndarjen e lokacionit për objektin e ngushëllimeve të lagjes Sahiti dhe Musolli në fshatin Pjetërshtic.
12. Informatë e përgjithshme nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme,

13. Informatë nga DKA për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë shkollor 2022/23,

14. Rekomandim për Ministrinë e Financave për faljen e 100 euro për tatimpaguesit e komunës së Shtimes, për vitin 2023.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi e lexoi rendin e ditës tha kemi pasur një propozim nga z.Mujota nga mbledhja e kaluar për me hekë pikën 13.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pa filluar mbledhjen desha me dhënë një sqarim, se Vetëvendosja po thotë se PDK-ja po i saboton mbledhjet e Kuvendit, e që nuk është e vërtetë. Unë kam fol me ju, dhe kjo i bien që ju e keni ndërpre mbledhjen. Ndërsa mbledhjen e 28.02.2023 e ka lëshuar edhe një anëtar i LB-së edhe një i pavarur.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë e ndërpreva mbledhjen, sepse e pashë që nuk po funksiononte dhe e thirra për sot se nuk ka asgjë të keqe. Unë jam këtu Kryesues i Kuvendit e nuk jam me u përgjigj për sa u përket shkrimeve të subjektit politik se çka shkruajnë ato në Facebook. Më vjen mirë që jemi të gjithë këtu, jemi të gjithë prezent, siç e dini mund të ketë vonesa por duhet ta mirëkuptojmë njëri tjetrin.

z.Adem Ramadani; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës, propozojmë një pikë shtesë për me e plotësuar KPF-në, si pikë e dytë e rendit të ditës.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ne u kemi dërguar një përgjigje nga Zyrtari Ligjor për zëvendësimin e anëtarit të KPF-së edhe po ua lexoi interpretimin për hire të qytetarëve. Kryesuesi lexoi interpretimin ligjor të zyrtarit ligjor (shih dokumentin) dhe tha ky është interpretimi ligjor. Le të vendos Ministria nëse është i ligjshëm.

z.Përparim Ramusa; Neve na vjen mirë që po reflektoni, ne po kërkojmë që kjo të jetë si pikë e dytë.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 10 vota "Për" me 11 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" nuk e miratoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit, që është dërguar me material.**

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota "Për" me 10 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" miratoi rendin e ditës me propozimin e pikës së 2 shtesë: "Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/54 për anëtarin e KPF-së"**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.01.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Unë po kërkojë që të mbajmë një minutë heshtje për humbjen e jetës së një të riu, Meriton Ajeti nga Davidovci 15 vjeçar në Itali. Kuvendi mbajti një minutë heshtje.

***Kuvendi Komunës së Shtimes, me 20 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 27.01.2023.**

Pika 2

Propozim-Vendim për ndryshimin e Vendimit Npi-01/54 për anëtarin e KPF-së

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Rrahman Jakupi; E para është skandaloze, interpretimi i zyrtarit ligjor, sepse nuk duhet bazuar në Procesverbal por në Stenogram, interpretim shumë i dobët. Ku e ka gjete ai se anëtari që do ta zëvendësoj duhet të jetë i gjinisë së njëjtë.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, te kjo pikë desha të lidhem, kishim një interpretim, mirëpo interpretimet po i bëjnë qysh po donë. KPF nuk ka funksionuar, sepse duhet të jetë me numër tek, e keni keqpërdor të drejtën e dyfishtë. Unë e propozoj Reshat Mujotën, për anëtar të KPF-së.

z.Reshat Mujota; Përshëndetje, unë e pranoj si propozim të Rexhës, por unë jam anëtar i Pavarur i Kuvendit. Unë e pranojë kandidaturën por i dua edhe votat e Vetëvendosjes, sepse Besniku ka thënë se unë po paragjykojë.

z.Besnik Seferi; Sa i përket pikës së dytë shtesë e kemi edhe një interpretim ligjor, por edhe nga Ministria ku thotë se duhet me qenë i të njëjtit subjekt, ndoshta është mirë që Reshati me dal e me votuar këndej për VV-në. Mirë është që është sjell në Kuvend, sepse mos të prishet puna në Kuvend dhe ky e jep vendimin final.

z.Përparim Ramusa; Rexha e dha një propozim për Reshatin. Nëse ti Besnik mendon se Reshati e meriton me qenë atëherë ja jep votën.

z.Reshat Mujota; Unë kam qenë andej te VV-ja dhe po e shoh rrëmujën. Besniku e ka dhënë fjalën për votën time. Unë e kërkojë votën nga ti dhe mos paragjyko për të tjerët.

znj.Saniye Sadiki; Përshëndetje, sipas interpretimit ligjor që e lexoi Kryesuesi ne si VV-ë e propozojmë Zejnije Veliun për anëtare të KPF-së.

z.Besnik Seferi; Reshati është edhe me një Komitet për Shëndetësi.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 21 anëtarëve, prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 11 vota "Për" me 5 vota "Kundër" dhe me 5 vota "Abstenim", vendosi që të plotësoi vendin e anëtares të Komitetit për Politikë dhe Financa, znj.Heroina Selmani nga Shtimja me zgjedhjen e anëtarit të ri, z.Reshat Mujota nga Mollopolci.**

Pika 3

Pyetje – përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Rrezartë Ramadani; Pyetje për DKA-në, në informatën që na keni dërguar thuhet se me datën 10.11.2022 ka filluar procesi i vlerësimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, ku janë identifikuar 25 nxënës, a kanë filluar këta nxënës të marrin mësimin që ata kanë nevojë, apo ende vazhdojnë në shkollën fillore?

z.Reshat Mujota; Përgjigjet që mi ka kthyer drejtoresha, unë kamë kërkuar përgjigje nga drejtori i atëhershëm e jo nga drejtoresha e tanishme. Kjo vërteton që unë nuk paragjykoj, sepse drejtoresha më ka thënë se unë po aludoj për drejtorin Lulzim Sahiti. Pyetja e dytë për DKA-në, që ka të bëjë me pagesat e shujtave për mësimdhënësit nga kontrata kolektive, të cilët ende janë nëpër Gjykata, ka qenë premtim nga Kryetari që do të kryhen të gjitha pagesat, nuk e di si do të bëhet pagesa e atyre që fitojnë në Gjykata, sepse ne e dimë që në buxhetin aktual nuk kemi planifikuar për këtë pjesë. Është mirë të dihet qka po ndodh në këtë drejtim, sepse dihet që është një vlerë e madhe e buxhetit dhe mund të na bllokoj edhe investimet kapitale. Pyetja e tretë për DKA-në, Çka po ndodh me konkurset e drejtorëve nëpër shkolla, kur dihet që dy konkurse janë anuluar, sepse nuk ka asnjë aplikantë, pse po ndodh kështu? Pyetja e katërt për DKA-në, kur do të përfundohet renovimi i Gjimnazit, "Naim Frashëri" sepse ka ankesa që "Institucioni i Arsimit dhe Aftësisimit Profesional" është demoluar nga numri i madh i nxënësve. Pyetja e pestë për DKRS-në, flitet për një sportist gjimnazist, Taulant Ramadani, 8 herë kampion i Kosovës. Ka shqetësim nga familja por edhe nga sportisti që nuk ka gjetur përkrahje nga Komuna. Thotë që nuk i është ndarë mirënjohje për sportistin e vitit, ka trokitur në derën e Komunës, u neglizhua, thotë që kam pasur premtim për mbështetje. Unë mendoj se duhet të mbështet, dhe drejtoresha e kulturës në takim me prindin e tij e ka thënë se na ke premtuar, ajo ka thënë që po rreni. Sa kam informata ky sportist është aq i zhgënjyer sa që e keni detyruar të migroj në Itali. Pse ky sportist u neglizhua, pse ky sportist nuk ka mirënjohje, pse nuk ka mbështetje kur është tetë herë kampion i Kosovës?

znj.Adelina Beqaj; Pyetja e parë për DSHMS-në jeni hy në vitin e dytë të qeverisjes, QMF-të në Petrovë dhe Godanc, pse ende nuk po funksionalizohen? Pyetja e dytë për DSHP-në, keni premtuar rregullimin e parkut të qytetit me fontanë e gjelbërim keni premtuar parqe edhe zgjidhjen e problemit të ujit të pijes, aty ku janë pishat keni premtua ndërtimin e Kompleksit Sportiv, keni premtuar ndërtimin e impiantit të ujit, ku jeni me procedura? Pyetja e tretë për DPUKGJ-në, keni premtuar rregullimin e unazës së vogël, unazës së madhe, ku jeni me procedurat?

z.Muhamet Ademaj; Pyetje për DSHP-në, 200 metra afër Palestrës Sportive ka deponi të mbeturinave, kur do të hiqen mbeturinat? Pyetja e dytë për DZHE-në, Fabrika Nica-Swiss në Gjyrvoc nuk mund të punojë për shkak të energjisë elektrike, a ekziston mundësia me i ndihmua këtij biznesi në rregullimin rrjetit të energjisë elektrike?

znj.Albana Podvoriva; Pyetja e parë për DKRS-në, edhe pse “Handikosi” ka bërë që një kohë të gjatë kërkesë më ja siguria zyrën, pasi që munden me e humbë edhe licencën, pse ende nuk i keni bërë zgjidhje lidhur me zyrat? Pyetja e dytë për DKA-në, 21 marsi është dita e Sindrom-Daun, a ka menduar drejtoria të realizoj ndonjë aktivitet për këtë ditë, duke i kontribuar parimit për gjithë përfshirje në arsim? Pyetja e tretë për DKA-në, si qëndron situata me sigurinë nëpër shkolla tu marr parasysh faktet që kemi në shkollën e Carralevës, që dy herë brenda një kohe të shkurt janë vjedhë pajisje, ka edhe raste tjera në shkollat tjera, prandaj dua të kem një informacion rreth kësaj çështje? Pyetja e katërt për DKA-në, në vizitën që e kemi bërë ne si Komitet për Arsim, në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani”, ndër sfidat e saj ishin mungesa e buxhetit, mungesa e pajisjeve të kuzhinës ku sfidë ishin edhe punëtorët që janë larguar nga ky Institucion edhe problemi me nxehje ku kishte ankesa edhe nga ana e prindërve, si planifikohet menaxhimi i këtyre sfidave nga DKA-ja? Pyetja e pestë për DKA-në, me planin e punës të kësaj drejtorie, a është planifikuar renovimi i paraleles së ndarë në Davidovc? Pyetja e gjashtë për DSHP-në, a ka mundësi që familjet që nuk kanë të punësuar apo janë me ndihma sociale për pagesat për grumbullimin e mbeturinave të paguajnë vetëm gjysmën e shumës apo të lirohen tërësisht nga pagesa. Pyetja e shtatë për Kryetarin, kishte thënë se do të funksionalizohet Çerdhja e vjetër, dua ta pyes pse nuk po funksionalizohet?

z.Përparim Ramusa; Pyetja e parë për DKA-në, si është e mundur që në Shkollën e Mesme “Naim Frashëri” që katër muaj profesor fizikës mungon? Pyetja e dytë për DKA-në, si është e mundur që në Shkollën e Petrovës “Bajram Curri” prej 1 shtatorit arsimtari i Edukatës Fizike mungon, shtu këtu faktin që qeverisjes aktuale gjatë vitit 2022 i kanë tepruar 180 mijë euro vetëm paga?

z.Asllan Beqaj; Pyetja e parë për DSHMS-në, Qendra e Mjekësisë Familjare në Petrovë po vazhdon të jetë ende e mbyllur edhe pasi ka pasur disa renovime, ajo çka po ju intereson banorëve atje është se kur do të bëhet funksionalizimi i saj përfundimisht që banorët të marrin shërbimet mjekësore? Pyetja e dytë për DSHP-në, kur do të bëhet pastrimi lumit Shtimjanja në pjesën e Petrovës si dhe kur do të bëhet zgjerimi pasi që është në projekt, sepse banorët për rreth po e shohin si shqetësim kur ka të reshura të mëdha? Pyetja e tretë për DSHP-në, shenjat e vendkalimeve mungojnë tash e disa muaj në rrugën “Tahir Sinani” kur do të vendosën këto shenja? Pyetja e katërt për DSHP-në, për deponit ilegale të mbeturinave, në pyetjen e kaluar ma kanë kthyer një përgjigje ku drejtori më thotë që kemi një plan por nuk e shpalos atë plan para qytetarëve si do ta rregullojnë këtë problematik të deponive ilegale?

z.Hamëz Tërshani; Pyetje për DPUKGJ-në, për mungesën e zebrave në qytet, që dy vjet është rregulluar sheshi, dhe është ankesa e qytetarëve mungesa e zebrave desha të marr një përgjigje nga drejtori për këtë ?

z.Adem Ramadani; Pyetje e parë për DSHP-në, për shenjëzimin e rrugëve për këmbësorë që është një pengesë e trafikut, ku këmbësorët kalojnë ku të munden, kur do të bëhet shenjëzimi i vendkalimeve për këmbësorë. Pyetja e dytë për DZHE-në, qenët endacak, këtë problematik e kemi ngrit që disa herë, por ende nuk është duke u marr asnjë veprim nga kjo drejtori?

z.Lumni Amrushi; Pyetja e parë për DSHMS-në, është pyetje që e kam bërë edhe vitin e kaluar, Laboratori në Pejtërshtic, vjet më ka thënë drejtori që nuk kanë planifikuar laborant, tash kam drejt me përsërit pyetjen me ditë se çka po ndodh tani me këtë laboratorë, kur do të funksionalizohet, a e kanë planifikuar tani këtë laborant? Pyetja e dytë për DSHP-në, para disa viteve ka pasur vërshime në fshatin Pjetërshticë, është bërë një intervenim në pastrimin e lumit dhe zgjerim, por prapë ka nis me u ngushtua lumi, a do të ketë para dimrit plan për zgjerim të këtij lumi?

z.Rrahman Jakupi; Pyetja e parë për DZHE-në, pse është bërë vonesa e procedurave për trajtimin e geneve endacak edhe kur do të fillojë? Pyetja e dytë për DSHP-në, për qenët endacak, lidhet me mos nënshkrimin e kontratës për mbeturina, kjo kontratë a po kushtëzohet me largimin e drejtorit të kësaj ndërmarrje? Pyetja e tretë për DSHMS-në, pse ekziston ushtrues detyre, drejtoresha e QKMF-së, ku

kanë kaluar më shumë se një vit? Pyetja e katërt për DSHMS-në, mungesa barnave, mungesa e mjekëve dhe infermierëve në QKMF-ë, a jeni duke pritur me diplomuar anëtarët e tuaj politik dhe me i punësuar ata, pse nuk po hapen konkurset?

z.Besnik Seferi; Pyetja e parë për DSHP-në, një trafo e rrymës në rrugën “Enver Gashi” në Shtime, është shqetësim, kur do të ndërmerret diçka për këtë trafo e të bëhet zgjidhje për këta qytetarë? Pyetja e dytë për DZHE-në, duhet të informohemi lidhur me çështjen e subvencionimeve që do të bëhen nga kjo drejtori? Pyetja e tretë për DSHMS-në, sa janë duke u kryer shërbimet stomatologjike në QKMF-ë? Pyetja e katërt për DSHP-në, a është e planifikuar që ndriçimi publik të bëhet edhe në rrugën “Ohri” në Shtime? Pyetja e pestë për DZHE-në, çështja e qeneve endacak është shqetësuese, pasi që e ngritën edhe kolegët tjerë, besoj dhe shpresoj që kjo drejtori të rregulloj këtë çështje një herë e përgjithmonë?

Pika 4

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023 (pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi Rekomandimin e KPF-së. Këtë pikë e kemi 2-3 herë në rendin e ditës. E keni kërkuar drejtorin e DSHP-së si dhe anëtarin e Komisionit të Aksionarëve për të dhënë sqarime shtesë.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Përshëndetje, unë e kam thënë edhe më parë se KRM “Pastërtia” njësia në Shtime ka kërkuar ngritjen e çmimeve për arsye të gjendjes financiare, kërkoj edhe nga Besniku si anëtar i Komisionit nëse ka diçka me shtuar.

z.Besnik Seferi; Unë si anëtar i Komisionit të Aksionarëve e kam bërë një raport me shkrim që e keni kërkuar, unë mund të ju them se kjo Kompani po punon me humbje. Është mirë që kjo të punojë si e pavarur nga Ferizaj. Aty kërkohet një kontroll dhe duhet të epet si vërejtje, sepse aty më shumë ka menaxherë se sa punëtorë fizik. Rritja e çmimit prej 1 euro nuk mendoj që është e madhe dhe nuk po bëhet vetëm në Komunën tonë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Sa e kuptova unë pra këta janë që të rriten taksat e shërbimeve.

z.Përparim Ramusa; DSHP-ja na dha një sqarim por i mangët, sepse kemi ne kemi kërkuar me e shqyrtuar mundësin e subvencionimit të KRM “Pastërtia” e nuk morëm përgjigje. Duke marrë parasysh ngritjen e çmimeve dhe gjendjen financiare vota ime do të jetë “Për”.

z.Adelina Beqaj; Po çuditë se si drejtori profesionist, sot këtu na erdhi me një përgjigje, se unë nuk di më shumë. Je ma serioz drejtor, sepse po prekë në xhepin e qytetarit.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për informatën e anëtarit të komisionit, mirëpo unë nuk kam parë se kanë bërë ndonjë punë atje. Në asnjë rresht në raport nuk përmendet anëtar i bordit, kur dihet rëndësia e tij. Pyetja e dytë unë kërkoj numrin e punëtorëve dhe pozitat e tyre a po marrin rroga? Kah të shkojmë ka deponi ilegale, e këtu në raport nuk ke thënë asgjë. Edhe unë kam qenë për ngritjen e tarifave, mirëpo si qëndron puna me kontratën me “Pastërtinë”. Unë propozoj që te amvisëritë të mos ngritën çmimet. Po ashtu duhet që në sistem të përfshihen të gjitha fshatrat.

z.Asllan Beqaj; Faleminderit, për raportin që e ka sjellë Besnik Seferi, sepse deri tani nuk ka pas një raport të tillë në Kuvend.

z.Hamëz Tërshani; Po kërkohet rritja e tarifave të “Pastërtia” pyetja ime është kujt po ja rrisim tarifat? Jeni që 4 muaj pa kontratë. Ne e kemi kërkuar një përgjigje për mundësinë e subvencionimit, këto informata ne i kemi kërkuar. Besnikun e falënderoj për informatën por janë të mangëta.

znj.Zejnije Veliu; Përshëndetje, askujt nuk i konvenon rritja e tarifave, por duhet të përkrahet për arsye të gjendjes së rëndë financiare të kompanisë si dhe për arsye të rritjes së çmimeve gjithandej.

z.Kadri Emini; Sa i përket Rregullores duhet të kalojë, por sa i përket kërkesës për rritjen e tarifave unë kam ardhur në përfundim se numri i punëtorëve aty në KRM “Pastërti” është shumë i madh, sidomos në administratë, dhe nëse vazhdojmë me një trend të tillë kjo ka me falimentuar. Sa i përket mosnënshkrimit të kontratës, unë mendoj se duhet të nënshkruhet.

z.Adem Ramadani; Pyetje për DSHP-në, a ka kontratë valide me KRM “Pastërtinë” apo jo?

z.Besnik Seferi; Po sqaroj diçka që ka të bëj me informatën. Duhet gjithsesi të rregullohet gjendja brenda kompanisë, më parë në Komision ka qenë Ferid Bilalli. Unë i kam cekë shpenzimet për një muaj që i kanë kompania "Pastërtia".

znj.Albana Podvorica; Faleminderit për Informatën. Mendoj se drejtori është dashur me na elaboruar më shumë. Kërkoj që në mbledhjen e radhës drejtori me na dhënë më shumë informata, se a mund të ketë subvencionim për kompaninë.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Nuk ka subvencionim për kompaninë "Pastërtia". Kontrata pritët të nënshkruhet shumë shpejt.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; A ta hedhim në votim kështu me rregulloren, apo ndaras?

z.Reshat Mujota; Pikërisht duhet me diskutuar për rritjen e taksave për kompaninë "Pastërtia". Por duhet edhe me dhënë sqarime për shpenzimet e bëra të kompanisë sepse këndeje po kërkojmë që me u rritë taksat. Këtu kemi të evidentuara blerje tjera 1940€ çka janë këto nuk ka fare sqarime?

z.Hamëz Tërshani; Nuk dua me hy në debat, por është absurde me thënë se nuk e din dallimin në mes kontratës në mes kompanisë dhe ekonomive familjare. Kërkesa ka qenë me e subvencionuar kompaninë pa e prekë xhepin e qytetarit. E keni pa tjetër për me rinovuar kontratën me KRM "Pastërtia". Kalkulimet e juaja politike nuk bënë me funksionuar.

z.Asllan Beqaj; Kur thae ti Kryesues se nuk ka nevojë me dhënë raport të detajuar për "Pastërtinë" nuk mundemi me i ngritë çmimet pa pas një raport të detajuar.

z.Perparim Ramusa; Po replikoj me drejtorin Bardhyl Rushitin, ke pas një prind të respektuar, mirëpo pas kësaj seance më nuk kemi me të kursyer nga kritikët. Eja në mbledhje të Kuvendit më i qetë dhe më i përgatitur, e mos hajde me arrogancë e me nervozë. Unë personalisht e votoj rregullohen me ngritjen e çmimeve të taksave.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Faleminderit për udhëzimin tënd. Unë natyrën e kamë të tillë, mirëpo unë nuk jam arrogant.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 19 anëtarëve, prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 15 vota "Për" me 1 votë "Kundër" dhe me 4 vota "Abstenim", vendosi që të miratoi, Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2023, me propozimin e DSHP-së, që të ngriten çmimet e taksave për shërbime të kompanisë KRM "Pastërtia".**

Pika 5

Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Përshëndetje, ne i kemi 15 rekomandime nga Auditori i përgjithshëm. 6 rekomandime janë në proces, ndërsa 9 janë të zbatuara, Në vazhdim z.Bujar Ferati lexoi raportin, (shih dokumentin). Nëse dikush ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Ekzekutivi e ka për detyrë për me i zbatuar rekomandimet e auditorit. E falënderoj ZKF-në për punën dhe le të vazhdojë me punën.

z.Muhamet Ademaj; Ky raport tregon gjendjen objektive dhe nuk mund të ndryshohet. Kërkojmë nga ekzekutivi që ti zbatojë rekomandimet kolektivisht.

z.Reshat Mujota; Shumica e rekomandimeve janë zbatuar. Kërkoj që të kryhen të gjitha.

z.Asllan Beqaj; E falënderoj zyrtarin për raportin, dhe e inkurajoj zyrtarin që ti zbatojë të gjitha rekomandimet e auditorit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 15 anëtarëve, prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Raportin Periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021.**

Pika 6

Raport financiar për vitin 2022 - Pasqyrat financiare

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Tha në vazhdim se e kemi një sqarim nga zyrtari ligjor se nuk ka nevojë të votohet kjo pikë, për arsye se veç është votuar një herë në mbledhjen e kaluar, megjithatë e hapi diskutimin për këtë pikë. Pasi që nuk ka diskutime për këtë pikë atëherë kalojmë në pikën tjetër.

Pika 7

Draft-Rregullore për Punën e Kuvendit dhe Komiteteve

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fillimisht lexoi rekomandimin e KPF-së dhe në vazhdim fjalën ja dha Asllan Beqaj, për prezantimin e kësaj pike, në cilësinë e kryetarit të Komisionit për hartimin e draft-rregullores për punën e Kuvendit dhe Komiteteve.

z.Asllan Beqaj; I falënderoj anëtarët e Komisionit për punën e bërë. Kemi mbajtur 5 mbledhje, dhe i kemi analizuar të gjitha nen për nen. Kemi marrë edhe mostra nga Komunat tjera. Kështu që kemi përgatitur për Kuvend një draft të rregullores të kompletuar. Unë ju ftoj që ta votojmë që kjo rregullore të shkojë në diskutim publik.

z.Reshat Mujota; Faleminderit për punën e Komisionit. Mua më ka pëlqyer, por propozoj që te neni 4 të plotësohet me qëllim që me e caktuar numrin e mbledhjeve 1 ose 2 mbledhje e jo me lanë ashtu.

znj.Adelina Beqaj; Ne si Komision kemi mbajtur mbledhje të shumta dhe kemi bërë punë të jashtëzakonshme. Te kjo pikë ne e kemi specifikuar individin e jo Kuvendin, mirëpo ne edhe mund ta diskutojmë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Si Kuvend ne mund të lidhemi on-line në kushte të veçanta, por jo edhe si individ.

*** Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Komisioni për Hartimin e Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve dhe Zyra për Informim.**

Pika 8

Draft-Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027 (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bardhyl Rushitit.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Fillimisht e falënderoj GIZ-in Gjerman për kontributin që ka dhënë në këtë plan. Mbi bazën e vendimit të Kuvendit për diskutim publik, ne e kemi organizuar dhe e kemi mbajtur një debat me qytetarë mirëpo nuk ka pas shumë pjesëmarrës në debat, prandaj edhe nuk ka pas ndonjë propozim konkret. Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lexoi rekomandimin e KPF-së.

z.Adem Ramadani; Në draft dokument shkruan 2022-2026, mendoj se është ndoshta gabim. Për Gurthyesit në dokument thuhet se janë disa me licenca e disa pa licenca. Unë mendoj se ata pa licenca nuk duhet lejuar të punojnë.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Sa i përket vitit, po është një gabim teknik, që do të përmirësohet. Ndërsa sa i përket të dhënave ato janë marrë nëpër agjencinë të ndryshme.

z.Adem Ramadani; Ato çka i keni marrë, jo me çdo kusht me i qitë në plan. Por duhet me ditë se çka me qitë në plan e çka jo.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit, për planin drejtor, ne mendojmë se ky plan duhet të votohet. Por unë e ngrij shqetësimin që duhet të caktohet sa më parë lokacioni për mbeturinat e ngurta.

z.Reshat Mujota; Ky plan është, kopy-paste ka qenë edhe në të kaluarën. Si draft me letra ne jemi okej, por unë kërkoj zbatimin e planit. Kërkoj nga drejtori që ta angazhojë Inspektoratin. Si draft edhe unë e përkrahu.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Këtë vit do ta bëjmë një plan për eliminimin e mbeturinave.

z.Përparim Ramusa; E falënderoj drejtorin për draftin, jam "Pro", por edhe unë sikurse Reshati kërkoj zbatimin e këtij plani të mbeturinave.

z.Adem Ramadani; Unë jam për me analizuar edhe pak këtë plan, kështu që unë nuk e votoj pa i bërë edhe disa ndryshime në këtë plan.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 19 anëtarëve, prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 15 vota "Për" me 2 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim", miratoi, Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për periudhën 2023-2027.**

Pika 9

Draft-Strategjia dhe Plan i Veprimit për mbrojtje nga dhuna në Familje 2023-2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Reshat Gashit.

z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore; Përshëndetje, dokumentin e keni marrë të shkruar, e keni diskutuar edhe në KPF-ë. Ky draft duhet të shkojë në diskutim publik, ju rekomandoj që ta votoni për diskutim publik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 17 anëtarëve, prezent në mbledhje.

*** Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimitisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për periudhën 2023-2025, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, Zyra e Kryetarit dhe Zyra për Informim.**

Pika 10

Draft – Plan Komunal për Integritet 2023-2027

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Valon Januzit.

z.Valon Januzi, drejtor i Administratës; Ashtu qysh jeni në dijeni ne e kemi përgatitur Draft – Planin Komunal për Integritet 2023-2027, materialin për këtë e keni marrë në formë të shkruar dhe e keni lexuar, unë ju rekomandoj që ta votoni, që ky plan të shkojë në diskutim publik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 17 anëtarëve, prezent në mbledhje.

*** Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimitisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft- Planin Komunal për Integritet 2023-2027, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Administratë të Përgjithshme dhe Zyra për Informim.**

Pika 11

Propozim-Vendim për ndarjen e lokacionit për objektin e ngushëllimeve të lagjes Sahiti dhe Musolli në fshatin Pjetërshticë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Grejtalb Eminin, dhe në vazhdim e lexoi rekomandimin e KPF-së.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, për këtë pikë ne e kemi pranuar një kërkesë nga lagjet Musolli dhe Sahiti të fshatit Pjetërshticë, po ashtu e kemi pranuar edhe një pëlqim nga BIK-u në Shtime. Ne e kemi dhënë rekomandimin tonë në formë të shkruar të cilin e keni pranuar me kohë, kështu që unë ju ftoj që ta miratoni.

z.Reshat Mujota; Unë jam që ta përkrahi, por në mandatin e kaluar ne kemi aprovuar një vendim të ngjashëm për fshatin Petrovë, dhe tani është në Gjykatë. Prandaj unë jam që objekti të jetë i destinuar pikërisht për krejt komunitetin dmth. për krejt fshatin Pjetërshticë. Kemi pas kërkesa nga ju për votë për dy objekte në fshatin Petrovë, por që nuk ka asnjë objekt, unë kam votuar "Për" sa i përket objektit në Petrovë, pse nuk po funksionon objekti në Petrovë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Lënda e Petrovës është në Gjykatë, kërkoj nga Lumi që të na sqarojë pak më shumë lidhur me këtë kërkesë të lagjeve në Pjetërshticë.

z.Lumni Amrushi; Po flas në emër të PDK-së është kërkesë e qëlluar për dy lagjet, dhe ne do ta përkrahim. Jemi pak keq me lagjen Gashi, por do të gjendet një zgjidhje. Unë ju lus që ta përkrahim këtë propozim-vendim.

z.Adem Ramadani; Ne krejt e përkrahim për dy lagje, mirëpo nëse votohet kjo për një lagje atëherë ne nuk kemi të drejtë për me i mohuar lagjet tjera me i refuzuar. Unë mendoj se duhet me qenë për krejt fshatin, sepse objekti mund të jetë edhe për nevoja të tjera e jo vetëm për ngushëllime.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ajo do të jetë shtëpi për komunitetin si tersi.

z.Besnik Seferi; Po pajtohem me diskutimin e Reshatit, sepse po del që secila lagje për veti me be kërkesë për objekte të tilla, dhe kjo nuk ka me u ndalë me kaq, sepse edhe unë mundem me bë një kërkesë për lagjen e Seferëve në Lagjen e Pajtimit. Kjo mua po më duket e pa logjikshme, prandaj unë mendoj se më mirë është me caktuar për krejt fshatin Pjetërshticë.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Ne mund të themi se objektin munden me e shfrytëzuar krejt fshati, edhe pse kërkesën e kanë bërë lagjet Musolli dhe Sahiti. Ka fshatra me specifika të ndryshme sikurse janë Carraleva, Pjetërshtica etj. që janë të shpërndara. Edhe unë kërkoj që objekti të jetë i destinuar për komunitetin e fshatit e jo vetëm për lagjet.

z.Reshat Mujota; Në të kaluarën i kemi votuar për lagje, jo vetëm në Petrovë por edhe në fshatrat tjera. Por ti drejtor nuk mu përgjigje në pyetjen time. Te lagja Ademaj ja keni shtruar edhe Asfaltin e në Petrovë brenda jo. Unë po kërkoj që objekti të jetë komplet për fshatin Pjetërshticë, për mos me krijuar përçarje mes lagjeve.

z.Përparim Ramusa; Na jemi për me dhanë atë. Vetëm le ti shtohet kjo që epet për ter fshatin Pjetërshticë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 17 anëtarëve, prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht miratoi vendimin që t'i lejoi komunitetit të fshatit Pjetërshticë për ta shfrytëzuar përkohësisht, pjesën e ngastrës kadastrale me numër P-72809064-01514-1, me një sipërfaqe prej S=500m² në Zonën Kadastrale – Pjetërshticë, Evidentuar Pasuri e Komunës së Shtimes, me qëllim të ndërtimit të një “Objekti për Ngushëllime” për nevoja të Komunitetit të fshatit Pjetërshticë.**

Pika 12

Informatë e përgjithshme nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Valon Januzit.

z.Valon Januzi, drejtor i Administratës; Përhëndetje, meqenëse materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, unë nuk do tu marr kohë për ta lexuar, por nëse ka ndonjë pyetje konkrete, unë do të përpiqem që të përgjigjem. (shih dokumentin)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse nuk ka diskutime e as pyetje po kalojmë në pikën tjetër.

Pika 13

Informatë nga DKA për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë shkollor 2022/23

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Yllkë Fejzullahu.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Përhëndetje, Informatën e keni marrë të shkruar në formë elektronike me kohë. Në vazhdim drejtoresha e lexoi informatën në tersi, dhe tha nëse ka ndonjë pyetje, unë do të bëj përpjekje që të përgjigjem. (Shih dokumentin)

znj.Albana Podvorica; Urime për pozitën e re. Faleminderit për informatën, por kjo informatë ka mungesë të cilat ose i dini ose nuk i dini. Sa keni njohuri se kurë do të përfundojë renovimi në shkollën Gjimnazi "Naim Frashëri"? Pastaj tjetra shumica e shkollave ballafaqohen me ujin e pijes nëpër shkolla.

z.Asllan Beqaj; Faleminderit për informatën. Ne si Komitet i Arsimit gjatë vizitave që i kemi bërë i falënderojmë për bashkëpunimin që kanë treguar. A keni ndërmarrë diçka shpejt për rregullimin e nxehjes qendrore? Problem gjithashtu është edhe parkingu i veturave te shkollat si dhe rreziku nga Qenët endacak. Te shkolla e fshatit Petrovë ka probleme me infrastrukturën shkollore.

znj.Adelina Beqaj; Urime për pozitën e re drejtoreshë, po ndërlihem te çështja e parkingut te Çerdhja ku e kishin ndreq por nuk është e mjaftueshme. Çerdhen e vizitojnë këta vetëm nëpër festa. Për Petrovë keni thënë se do ta bëjmë një shkollë të re. Kërkoni në Ministri sepse Komuna nuk ka Buxhet. Pse po i politizoni shkollat me militant të VV-së.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Parkingu te Çerdhja është për punonjësit aty, e jo për prindërit për me i parku aty automjetet, po e them me shaka për me e relaksuar pak gjendjen.

z.Reshat Mujota; Punë të mbarë drejtoreshës në detyrën e re. Ai i mëparshmi e ka lënë gjendjen tmerr. Cilat janë kriteret e punësimit të asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara? Kur do ta zgjidhni problemin e transportit për nxënës? Ka shpërngulje të nxënësve në fshatin Mollopolc dhe rrezikon që të mbyllet ndonjë paralele. Nëse organizoni transportin e nxënësve atëherë le të bëhet edhe për nxënësit e shkollës së mesme. Edhe kërkoj që ta tërhiqni fjalën për sa i përket thënies tuaj se po aludoj kur kam fol për tërheqjen e Lulzim Sahitit.

z.Lumni Amrushi; I uroj drejtoreshës punën e re. A e ke vizituar apo ende jo shkollën në Pjetërshticë, ajo shkollë pret rrënim, mos prit mu be si shkolla në Ferizaj. A keni komunikua me Ministrinë për Palestrën e sportit. U demolua komplet oborri shkollës edhe rrethoja edhe disa të tjera që ka kjo shkollë.

z.Reshat Mujota; Unë bëra pyetje për drejtorinë për sa u përket kriterëve. Nepotizëm ke edhe ti Kryesues, do ta them kur vjen koha, për sebetet e tua. E drejta vret e di por për ata të padrejtë. Katastrofë është arsimi, kurrë më keq nuk ka qenë. E kam parasysh se drejtoresha do të punon mirë sepse ka ambicie politike. Nuk ki emërime të drejtorëve, shkolla jo funksionale si në Carralevë etj, shkoi koha me renovime.

z.Përparim Ramusa; I uroj drejtoreshës pozitën. Po më befason qëndrimi i Qemajl Aliut se ka thënë që te Arsimi e te Shëndetësia jo drejtorë politik. Në Pjetërshticë kanë emëruar drejtor kandidatin e Nismës në nivel qendror. 180.000€ ju kanë tepruar në paga. Çka keni bërë për zëvendësimin e orëve të humbura gjatë Pandemisë. Për obligimet e Kontratës Kolektive a janë përmbushur për sa u përket arsimtarëve. Çka ka ndodhur me renovimin e shkollave, pse po bëni renovime gjatë procesit mësimor? Çka ka ndodhur me tre shkollat që janë vjedhur kompjuterët?

z.Besnik Seferi; Faleminderit për Informatën. Mirë që ka shumë pyetje për DKA-në sepse kjo tregon se ka punë mjaft shumë. Në të ardhmen të na i biesh konkurset dhe listën e të punësuarve. Shkolla fillore në Lagjen e Pajtimit ka problem me ngrohje me tualet, kur do të rregullohen?

z.Rrahman Jakupi; Urime drejtoresh detyrën. Uroj të punoni drejt. Krejt këto telashe që i përmendën kolegët janë pasojë e ish drejtorit që e ka bërë një krahurë në arsim. Drejtori i mëparshëm e ka pas qëllim vetëm me shkua e me i nxënë diçka gabim drejtorët e shkollave. Keqpërdorim me konkurset. Keqpërdorim me Karitasin. Te grevat ai plotësisht ka dështuar. Keqpërdorimet me dru për ngrohje e të tjera, po bëhen shumë vepra penale, por ka kush merret me to.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pajtohem që arsimi duhet me u përmirësuar, sepse ka qenë shumë keq. Mirëpo ne si Komunë duhet që ta ndihmojmë edhe arsimin por edhe sektorët tjerë. Unë po them se nëse dikush gjanë shkelje ligjore, le ti adreson ku duhet te prokuroria. U bënë shumë pyetje për drejtoreshën me të drejtë sepse po shihet që ka shumë punë për tu bërë në arsim.

znj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Faleminderit për pyetjet. Po mundohem që me dhënë përgjigje për të gjitha pyetjet me aq sa kam arrite me i shënuar. Renovimi i gjimnazit "Naim Frashëri" shumë shpejt do të përfundohet. Nxehja në Çerdhe është rregulluar, dhe e vizitoj gati çdo dytën ditë e jo vetem festave. Punën e kam marrë tash frik që një muaj, dhe jam duke analizuar gjendjen në arsim, kështu që vizita nëpër objektet arsimore kudo do të realizojë gjithëherë. U fol për politizimin e shkollave, unë nuk kam vërejtë kurrfarë politizimi të shkollave dhe nuk kam vërejtë asnjë parregullsi në konkurse, e inkurajoj secilin që sheh ndonjë parregullsi le ti adresojë ato. Tani ne i kemi nda 60.000€ për renovimin e shkollave. Reshat Mujota pyeti për kriteret sa i përket Asistentes për fëmijët me nevoja të veçanta, përgjigja është se këtë e rregullon U.A. Për sa i përket transportit të nxënësve ne po mundohemi që të bëjmë zgjidhjen më të mirë të mundshme. Pyetjet për ish drejtorin është mirë që të adresohen te ai, sepse unë nuk mund të flas për te. Lumni Amrushit do ti jap përgjigje me shkrim. z.Ramusa foli për emërime politike. Në Gjimnaz aty është një profesore e lëndës së fizikës. Edhe për edukatë fizike për sa të përfundojnë procedurat e ankesave ne do ta angazhojmë menjëherë. Po ka pas disa vjedhje në shkolla që po më duket e pa logjikshme, mirëpo sa e di organet po e bëjnë punën e tyre. Rreth konkurseve, që Besniku e kërkoi listën, e bën kërkesën dhe ne do ti japim të dhënat sipas ligjit.

Rekomandim për Ministrinë e Financave për faljen e 100 euro për tatimpaguesit e komunës së Shtimes, për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ne kemi diskutuar në KPF-ë për këtë çështje dhe i kemi rekomanduar unanimisht Kuvendit që ta bëjmë një rekomandim për Ministrinë e Financave, me qëllim që të falen nga 100 euro për tatimpaguesit e komunës së Shtimes, për vitin 2023. Po e hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Reshat Mujota; Unë kamë thënë se kjo është qesharake, edhe është kundërligjore, prandaj unë këtë nuk po e shoh të arsyeshme për me votuar. Të hyrat ne i kemi prej tatimeve, e kam analizuar mirë sepse jam tatimpagues mjaft i madh. Ju si VV-ë po punoni sot për nesër.


z.Përparim Ramusa; Ne e kemi bërë një rekomandim në KPF-ë dhe unë mendoj se kjo është një lutje për Ministrinë e Financave. Me këtë keni bërë edhe populizma duke thënë se do ta thirrëm një mbledhje të jashtëzakonshme. Meqenëse po e bëjnë edhe komunat tjera, po e bëjmë edhe ne, kështu që vota ime do të jetë "Për".

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 18 anëtarëve, prezent në mbledhje.

*** Kuvendi Komunës, unanimisht miratoi Rekomandimin për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës, që të merr në shqyrtim mundësinë e faljes të 100€ për Tatimpaguesit e Komunës së Shtimes për vitin 2023.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e Kuvendit e përfundoi në ora 13:15h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

